



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.331/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore: Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë Anr.33/2019 e datës 06.10.2019, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,700.00 (një mijë e shtatëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paraqitësi i ankesës Lëvizja Vetëvendosje, me datën 06.10.2019, ka paraqit ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2019, rreth orës 16:45 gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, duke bërë thirrje për votim. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerja e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të miratohet e bazuar.

Në përgjigjën në ankesë, të datës 07.10.2019, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se ankesa e bërë nga Lëvizja Vetëvendosje është e pabazuar për arsye se postimi në FB nuk mund të jetë nga faqe zyrtare e PDK-së. Më tutje ka theksuar se në bazë të fotos së ofruar nga ankuesi shihet qartë se hapjan e faqes FB mund të përdoret nga secili individ që ka qëllime të caktuar dhe kërkojnë nga pZAP-i, ankesën ta hudhë si pa bazë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës shihet qartë se nga postimi i faqës zyrtare të PDK-së është bërë thirrje për të votuar subjekti i tyre politik, duke theksuar se votuesit të cilën nuk kanë transport të kontaktojnë numrin e telefonit 044668205, veprime këto të ndaluara sipas nenit 36 paragrafi 1 të LPZ-së, i cili përcakton se : “Njëzetekatër (24) orë para hajes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

- a) Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër ndonjëherë nga qendrat e votimit ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloje materiali me qëllim ndikimi tek votuesit;
- b) Bërja e fushtës në çfardo mënyrë”.

Sa i për ketë pretendimeve të subjektit politik PDK në përgjigjen në ankesë i cili thekson se , ankesa e bërë nga LVV është e pabazuar për faktin se postimi në FB nuk mund të jetë faqe zyrtare e PDK-së. Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto thënie nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 36 par.1 pika a) dhe b) i LZP-së.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 36 paragrafi 1 të LPZ-së , pasi që në provat e ofruara nga postimi në rrjetin social facebook shihet qartë numri i telefonit, mesazhi i dërguar për ofrim të transportit për votim.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti është thyer heshtja zgjedhore ku përmes rrjetit social ka bërë thirrje qytetarëve për të votuar subjektine tyre PDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen dhe për më tepër ka deklaruar se ky veprim i tyre

nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.331/2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.